



## Vargjet satanike dhe pamundësia e fundamentalizmit të dyshimit

### Description

*Parvez Manzoor*

Nëse sarkazma e Selman Rushdiut ka shkaktuar shumë shqetësim në zemrat e myslimanëve, sidoqoftë reagimi i myslimanëve i ka dhënë Leviathanit perëndimorë arsye të mira për të kremtuar kultin e tij të tolerancës. Sepse, perëndimi mund tanimë të deklarojë veten me të drejtë si bashkësia e shenjtoreve që i jep jetë fjalës së lirë dhe i ndëshkon myslimanët si një konfederatë mëkatarësh të cilët janë të përбетuar për ta vrarë fjalën e lirë. Tanimë Perëndimi mund të proklamojë në mënyrë triumfante se ndërsa kompozimi i një libri është një akt i shenjtë, djegia e librave është një sakrilegj, se ndërsa mbrojtja e lirisë së shprehjes të Selman Rushdiut është diçka hyjnore, dënimi saj me heshtje është diçka djallëzore. Për më tepër, ndonëse Perëndimi nuk është shqetësuar të sjellë asnjë të dhënë në favor të themelit intelektual dhe moral të këtij gjykimi, përveçse një shfaqje të egër të forcës së tij civilizuese, me përshkallëzimin e konfliktit, këmbëngulja e perëndimit në drejtësinë e pohimeve të tij është bërë më e vendosur.

Megjithëkëtë, ajo që është anashkaluar gjatë tërbimit rreth publikimit të fetvasë nga ana e Ajatollah Khomeinit është imoraliteti i mesazhit të dyshimit të propozuar nga Selman Rushdiu. Ajo çka mbështetësit e tij kanë anashkaluar vërbërazi është fakti se premisa themelore e romanit “Vargje Satanike”, nëse do të merrej seriozisht, minon mundësinë e çdo gjykimi moral ndërmjet dy palëve kundërshtarë, për të mos thënë që ajo mohon në tërësi gjykimin moral dhe kognitiv (njohës). Pa qenë nevoja e grindjes rreth vlerës artistike të veprës së Selman Rushdiut, si përkrahësit ashtu edhe kritikët e tij duhet të jenë të aftë të bien në ujdi mbi faktin se pohimi themelor moral i romanit është se ajo çfarë e dallon hyjnoren nga djallëzorja është, në rastin më të mirë, diçka arbitrare. *Nga ana kognitive (njohëse) në botën e Selman Rushdiut të gjitha macet janë gri dhe moralisht të gjitha lopët janë jo të shenjta.*

Megjithëkëtë, vënia në rrezik e jetës së tij, menjëherë pas daljes së fetvasë së Khomeinit, e detyroi Selman Rushdiut të “lutet për mbrojtjen e jetës së tij” duke u bazuar mbi faktin se fetvaja e Ajatullah Khomeinit ishte një shkrim djallëzor që përbën një shkelje të pafalshme kundër moralitetit dhe qytetërimit, kështu që, ndërsa ai pretendon se publikimi i romanit të tij është një çështje e të drejtës së shenjtë të lirisë së shprehjes, të cilën çdo person i drejtë është i obliguar ta ruajë, ai tregohet i paepur në pohimin se opinion ligjor i juristëve (fetva), i cili mishëron një urdhërim djallëzor, nuk e gëzon një privilegj të tillë. Në të vërtetë, ai këmbëngul se nëse është e

nevojshme fetvaja e khomeinit duhet ndaluar madje dhe falë dhunës së saksioneve ekonomike dhe masave të tjera që demonstrojnë plotësisht fuqinë e tolerancës. Nëse çështja është kështu, atëherë pyetja dhe habia jonë është: Përmes ushtrimit të cilës normë të lartë mund t'i lejojmë një teksti të drejtën e shprehjes së lirë dhe të publikimit dhe në të njëjtën kohë t'ia mohojmë këto të drejta një teksti tjetër? Shkurtimisht, si mund të arbitrojmë ndërmjet këtyre dy teksteve konkruuese?

Ironia këtu qendron në faktin se fundemantlizmi i dyshimit i përqafuar nga Rushdiu nuk na lejon të japim asnjë lloj gjykimi. Sepse, nëse Selman Rushdiu beson vërtet, ashtu siç propagandon paturpësisht në romanin e tij, se e shenjtja dhe djallëzoria janë etiketime arbitrare që i ngjiten teksteve nga ana e besimtarëve të thjeshtë, të cilat lehtësisht mund të ndryshojnë vende si edhe të ndërshtihen, atëherë e njëjta vlen edhe për këto dy tekste bashkëkohore, d.m.th. romani i Selman Rushdiut dhe fetvaja e Khomeinit. Ne nuk mund të bëjmë dallim ndërmjet shkrimit “vrasës” të Khomeinit dhe shkrimit thjesht poshtërues apo fyes të Selman Rushdiut. Pa një themel moral për të dhënë gjykime nuk mund as të ndëshkojmë juristin (khomeinin) dhe as të mbrojmë romancierin (Rushdiun), sepse një botë standartesh arbitrare, kontingjente dhe të papërcaktuara është një botë pa veprim dhe pa zgjedhje. Ajo është një botë e privuar nga çdo imperativ moral.

Nëse ky përfundim i yni duket drakstik dhe i ashpër dhe nëse mbi baza morale jemi të detyruar të pohojmë pamëdyshje “të drejtën për të jetuar” të Rushdiut, atëherë bëhet i pakundërshtueshëm fakti se arti i Rushdiut mishëron një gënjeshtër kolosale. Kjo sepse ky roman skandaloz propagandon një doktrinë të dyshimit që kanonizon mosveprimin dhe pavendosmërinë, ndërkohë që ruajtja e jetës së romancierit kërkon besim dhe angazhim. Asnjë lloj fundamentalizëm dyshimi nuk mund të ndajë ndërmjet artit të Rushdiut dhe jetës së tij, ndërmjet një gënjeshtre të trilluar dhe një të vërtete ekzistenciale. Vetëm një imperativ kategorik, i cili nuk mund të derivohet nga asnjë etikë kontingjente apo relativizmi, mund të thërrasë vullnetin moral për të vepruar. Nëse obligimi për të ruajtur jetën e romancierit, i cili bie mbi të tjerët, e bën gjithashtu detyrë mbi vetë shkrimtarin që të tërheq mbrapsht “fundamentalizmin e tij të dyshimit”, është diçka e cila mund të lihet e pashprehur. Por, ajo që nuk mund të kalohet në heshjte është fakti se Rushdiu nuk mund të ketë asnjë pretendim moral kundrejt atyre që e pranojnë mesazhin e tij posmodernist. Vetëm ata që refuzojnë relativizmin e tij intelektualisht të cekët dhe paralizues, i cili është thelbi i botëkuptimit moral të Rushdiut, të paktën ashtu siç predikohet në këtë roman skandaloz, mund të thirren në mbrojtje të jetës së tij!

Megjithëkëtë, mund të ekzistoj një tjetër lexim më i çiltër dhe shpjegues i tekstit polemik të Rushdiut. Është e mundur që ai të shihet si dikush që nuk deklaron pamundësinë e plotë të formimit të gjykimit moral, por si dikush që është thjesht duke rrëfyer një histori rreth një ngjarjeje historike. Ai mund të interpretohet sikur është thjesht duke këmbëgullur se Profeti i Islamit nuk mundi të dallonte ndërmjet tekstit të shenjtë dhe vargjeve satanike. Thënë më thjesht, Rushdiu mund të interpretohet sikur është duke pohuar se ndonëse ekziston mundësia për të shquar të drejtën nga e gabuara, të vërtetën nga falsifikimi, të shenjtën nga djallëzoria, gjithsesi kjo mundësi nuk ishte në dispozicion të Profetit ose se ai në një rast specifik nuk pati mundësi ta ushtroj një mundësi të tillë. Me fjalë të tjera, romani kontroversial i Rushdiut nuk është një pasqyrim mbi problemin e *mundësisë* së zgjedhjes, por mbi *realizimin* e një zgjedhjeje të veçantë. (Është interesant të vërehet se ndonëse Rushdiu do të mohonte mundësinë – apo realitetin – e zgjedhjes së drejtë, gjithsesi ai nuk ka asnjë dyshim rreth aftësisë së bashkëkohësve të tij për të gjykuar midis tekstit të tij dhe fetvasë së khomeinit dhe për të ardhur, pas kësaj, në ndihmë të tij!).

Nëse ky interpretim është i saktë, atëherë romani nuk bën fjalë për metafizikë apo filozofi, por për histori dhe ndryshe nga protestat e varfra të Rushdiut pas publikimit të fetvasë, romani jep një gjykim moral mbi Profetin. Por, atëherë si mund të bazohet një gjykim moral mbi një rrëfim të trilluar, madje

imagjinatë? Ose Rushdiu dëshiron të japë një gjykim moral mbi Profetin, në një rast të tillë një ligjërim rreptësisht historik do të kishte qenë i domosdoshëm, ose ai synon të mos japë asnjë gjykim moral rreth Profetit, gjë e cila e bën krejt të pakuptueshëm tërë ndërmarrjen e tij imagjinare, së bashku me ballafaqimin e ngatërruar të teksteve nga jeta e Profetit, përpikmërisht të riprodhuara në roman, me përfytyrime trashanike, të turpshme, të trilluara nga vetë ai. Nuk është çudi atëherë që myslimanët e shohin atë si djallëzisht të pasinqertë!

Kjo na sjell në thelbin e argumentit mysliman kundër romanit, d.m.th. se gjykimi moral është i mundshëm vetëm mbi baza historike dhe se në rastin kur terreni është i shenjtë, siç është rasti i jetës së Profetit, atëherë jo vetëm imagjinata profane, por edhe përkushtimi i devotshëm duhet të qëndroj brenda kufijve të realitetit historik. Natyrisht, thënia tradicionale se “shejtani nuk mund të shtiret sikur është Profeti, madje as kur shfaqet në ëndërr” shpreh në mënyrë grafike këtë qasje që sapo përmendëm si edhe i vendos limite çdo ligjërimi publik rreth Profetit. Çdo gjë që dikush thotë rreth Profetit duhet të jetë e lidhur drejtpërdrejt me personazhin historik të Profetit dhe jo me ndonjë figurë të panjohur të imagjinatës individuale. Me pak fjalë, rrënja e këtij konflikti është angazhimi islam ndaj historisë dhe moralitetit (një cilësi kjo që Islami e bashkëndon me besimet e tjera abrahamike), i cili është armiqësor ndaj mitikes, polimorfikes dhe kundër imagjinatës në thelb amorale të romancierit postmodernist.

Disponueshmëria e zgjedhjes, ose mundësia e gabimit në gjykimin njerëzor, është një fakt i rëndomtë që nuk mund të shenjtërohet dhe të shndërrohet në një teori paralizuese të relativizmit moral. Vetëm ata që shfaqin një doktrinë shtypëse të natyrës polimorfe, madje politeiste, të të vërtetës përfundimtare janë të gatshëm të veprojnë në këtë mënyrë. Për të tjerët, aftësia jonë për të vepruar moralisht shërben si një mburojë e fuqishme kundër çdo fundamentalizmi pervers të dyshimit. Kësisoj, nuk është aspak rastësi që tradita myslimane, e cila u përball me rrëfimin e trilluar të “vargjeve satanike” me të gjithë seriozitetin e saj, nuk u skandalizua asnjëherë nga kjo histori. Sepse tradita islame pranon qartësisht se fakti rëndom i vëzhgueshëm se zgjedhjet mund të jenë të gabuara nuk provon faktin se ato nuk mund të jenë asnjëherë të drejta! Ekzistenca në botë e gabimit dhe gënjeshtërisë nuk është provë për mosekzistencën e saktësisë dhe të vërtetës. Kësisoj, leximi tradicional i ngjarjes së “vargjeve satanike” është saktësisht e kundërt me atë të misionarit modern dhe të favorizuarve të çrrënjësuar të tij, si puna e Selman Rushdiut. Sepse ajo që përçohet nga ngjarja e “vargjeve satanike” është se dallimi është i mundur të kryhet dhe se zgjedhja e drejtë mund të ushtrohet. Në vend të se heq dorë nga pretendimet e arsyes njerëzore dhe të bluaj në mendje “eklipsin e Zotit”, tradita islame pohon fuqishëm mundësinë e njohjes së saktë dhe veprimit të drejtë dhe proklamon triumfin përfundimtar të tekstit të shenjtë mbi ndërshtirjet djallëzore.

Natyrisht, askush nuk është duke sugjeruar se postmodernistët e tërbuar apo romancierët e hutuar kanë inauguruar mbretërinë e relativizmit dhe kanë abroguar tërësisht gjykimin moral dhe juridik. Jo, etika e tyre molisëse dhe relativizuese ka pasur impakt të pakët mbi teorinë dhe praktikën bashkëkohore të politikës. Atë që ata kanë arritur në vend të kësaj është t'i bëjnë të respektueshme doktrinën jobarazimtare dhe elitiste që pranojnë si gjendje natyrore të gjërave hierarkinë e tanishme të pushtetit dhe privilegjit. Fundamentalizmi i dyshimit nuk i ka hapur rrugën asnjë pluralizmi të mirëfilltë. Gjithçka që ai ka bërë është të lehtësojë perceptimin e botës politike si një arenë “përplasjeje qytetërimesh” dhe standartesh të dyfishta.

Një botë standartesh të dyfishta paraqet, natyrisht, një botë ku nazizmi do të ndjehej krejtësisht si në shtëpinë e tij dhe ku askush nuk do të shqetësohej nga problemi i shquarjes së tekstit hyjnor nga falsifikimet djallëzore. Për tu shprehur çiltërsisht, të flasësh për nazizmin në këtë kontekst nuk është as e rastësishme dhe as mungesë respekti për viktimat e tij. Sepse këtu, si edhe gjatë, një nga çështjet

morale në lojë është lidhja e të vërtetës me historinë. Përballë shfaqjes së shkollës revizioniste historografike neo-naziste, në parlamente të ndryshme evropiane është propozuar zellshëm që mohimi i realitetit historik të holokaustit të deklarohet një vepër penale. Është argumentuar se një qendrim i tillë kundrejt një tragjedie të madhe njerëzore dhe një dështimi moral të kohëve tona nuk përbën një çështje të lirisë personale, qoftë kjo liri e ndërgjegjes apo e shprehjes. Personalisht një qendrim i tillë më duket krejtësisht i justifikuar. Një gënjeshtër morale, në fund të fundit, presupozon një gënjeshtër historike. Lërimi ata që dëshirojnë të pranojnë gënjeshtërën e nazimit të kenë “ndërgjegje të lirë”; lërimi ata të zotërojnë çfarëdolloj gjykimi që dëshirojnë mbi mësimet e nazizmit. Por, ata nuk mund të lejohen ta bazojnë gjykimin e tyre mbi histori të gënjeshtërt, apo të përlligjin zgjedhjet e tyre mbi bazën se genocidi kundër hebrenjve nuk ndodhi asnjëherë apo se dhomat e gazit janë thjesht “një fantazi e çifutëve”! Fatkeqësisht, kjo është pikërisht ajo që Rushdiu bën në romanin e tij: Nisur nga një narrative që është po aq afër së vërtetës së jetës së Profetit sa ç’është revizionizmi neo-nazist kundrejt holokaustit, ai nxit një gjykim mbi Profetin e Islamit!

Përktheu:Rezart Beka

**Date Created**

26/11/2016

**Author**

erasmusi